

DOCUMENT TYPE
PLACE

External/internal document

**University “Luigj Gurakuqi” |
Shkodër | ALBANIA**



FINAC

FINancial management,
Accounting & Controlling
in public administration

**Financial Management, Accounting & Controlling curricula
development for capacity building of public administration**

**Report on the implementation of the Professional Master study
program: “Financial management, accounting and control in public
administration” at Faculty of Economy, University “Luigj Gurakuqi”,
Shkodër, Albania**

1. Një panoramë e përgjithshme e ecurisë së programit

Programi Master Profesional në “Menaxhim financiar, kontabilitet dhe kontroll në administratën publike” nisi procesin e tij mëimor më datë 24 Nëntor 2018, pas marrjes së liçensës përkatëse për hapjen e programit, sipas Urdhërit Nr. 702, Dt. 19 Tetor 2018, të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë së Shqipërisë. Njoftimi për marrjen e liçensës mbërriti në një moment shumë të veçantë për Fakultetin Ekonomik të Univesitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, ndërkohë që ai po përgatitej të festonte 25-vjetorin e themelimit të tij.

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 38, ndër 40 kuotat e aprovuara nga Ministria e Arsimit. Në fakt, numri i studentëve që aplikuan për këtë program fillimisht ishte 41, por vetëm 38 prej tyre u regjistruan. Të gjithë studentët e regjistruar punojnë në administratë publike, me përjashtim të dy prej tyre, njëri prej të cilëve është mësues dhe tjetri i vetëpunësuar. 55% e studentëve të regjistruar zotërojnë një diplomë Bachelor në Shkencat Ekonomike, ndërkohë që të tjerët zotërojnë një diplomë Bachelor në Informatikë, Juridik, Gazetari apo në Shkencat e Edukimit. Gjysma e tyre janë pjesë e administratës së Universitetit të Shkodrës, në një kohë që pjesa tjetër punon në Bashkinë e Shkodrës, atë të Lezhës, Drejtorinë Rajonale të Taksave, Gjykatën e Apelit Shkodër, në një zyrë të regjistruar kontabiliteti, në një shkollë publike, dhe siç e përmendëm edhe më sipër, njëri nga studentët është i vetëpunësuar.

Për realizimin e procesit mësimor është krijuar vetëm një klasë, ndërkohë që për procesin e praktikës profesionale klasa është ndarë në dy grupe. Secili grup mbështetet dhe mbikqyret nga dy pedagogë¹, si në vijim: grupi i parë nga Prof. As. Elidiana Bashi (Përgjegjëse e Departamentit të Financë-Kontabilitetit), Prof. Dr. Arjeta Troshani (Departamenti I Turizmit), dhe grupi i dytë nga Prof. As. Dr. Ardita Boriçi (Përgjegjëse e Departamentit të Administrim-Biznesit), Prof. As. Dr. Blerta Dragusha (Dekane e Fakultetit). Pedagogët e mëposhtëm janë angazhuar në procesin mësimor gjatë semestrit të parë: Dr. Albana Kastrati, Prof. As. Dr. Ermira Kalaj, Dr. Pulti, Dr. Erjola Barbullushi and Prof. Dr. Elez Osmani. Nga ana tjetër, Dr. Nevila Kiri, Dr. Peter Saraçi, Dr. Kleida Heta, Prof. Dr. Fatbardha Molla, Mario Çurçija, PhD, Prof. Dr. Arjeta Troshani and Prof. As. Dr. Brilanda Bushati, janë angazhuar gjatë semestrit të dytë. Vetëm një klasë është krijuar për çdo kurs të ofruar gjatë semestrit të parë, ndërkohë që për lëndët me zgjedhje janë hapur 5 klasa në semestrin e dytë. Vetëm një nga lëndët me zgjedhje të propozuara nuk është hapur.

Ndër 38 studentët e regjistruar, 28 i kanë ndjekur lëndët e ofruara në mënyrë të rregullt. Gjithashtu, nga 38 te regjistruar 29 studentë kanë marrë pjesë në provimet e semestrit të parë. Norma e kalueshmërisë ka qenë 100% në të gjitha lëndët, ndërkohë që sezoni i riprovimeve për këtë semestër zhvillohet gjatë periudhës 13-31 Maj 2019. Në semestrin e dytë, i cili është në proces, mësimi dhe praktika profesionale janë integruar së bashku brenda çdo jave të planit për këtë semestër. Gjatë tre ditëve të para të javës studentët janë të përfshirë në proces mësimor,

¹ Mbështetur në Udhëzimin Nr. 29, Dt. 10.09.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë

ndërsa dy ditët e tjera ata janë të angazhuar në praktikë profesionale, të cilën e zhvillojnë në qendrat e tyre të punës. 28 nga 38 studentët e regjistruar kanë filluar punën për hartimin e detyrës së praktikës dhe tezës së diplomës. Nuk ka përjashtime mbi atë se cili student do zhvillojë temë diploma në përfundim të studimeve apo jo. Kjo mundësi u është dhënë të gjithë studentëve.

Lidhur me feedback-un e studentëve mbi programin, duhet theksuar që ata janë veçanërisht të kënaqur më qartësinë e lektorëve në shpjegimin e çështjeve teorike dhe praktike të lëndëve të ndryshme të ofruara gjatë semestrit të parë. Ata kanë vlerësuar gjithashtu faktin që kurrikula e këtij programi i është përkushtuar kryesisht proceseve të menaxhimit financiar, auditimit dhe kontrollit në institucionet publike, e specifikisht përfshirjen në çdo lëndë të shembujve nga çështjet dhe problematikat e administratës publike në Republikën e Shqipërisë. Për një feedback më të detajuar të studentëve rreth lëndëve specifike, ju lutem referojuni seksionit 3 të këtij raporti.

Duhet theksuar gjithashtu, që gjatë zbatimit të projektit, stafi i Fakultetit Ekonomik dhe përfaqësues të strukturave drejtuese të fakultetit dhe Universitetit të Shkodrës, kanë marrë pjesë në disa vizita studimore. Këto të fundit kanë qenë mjaft të dobishme në sigurimin e mbështetjes dhe trainimit të duhur të stafit dhe strukturave drejtuese në arritjen e objektivit bazë të projektit FINAC, hapjen e programit të studimit të sipërpërmendur. Numri i individëve që kanë marrë pjesë në këto vizita, gjatë periudhës Qershor 2017-Dhjetor 2017 shkon në rreth 17 vetë, ku shumica kanë marrë pjesë në 2 vizita studimore.

2. Plani mësimor i programit të studimit dhe stafi akademik i përhirë

Më poshtë është prezantuar plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim Financiar, Kontabilitet dhe Kontroll në Administratën Publike”. Ky plan paraqet lëndët përkatëse me ngarkesat përkatëse, kreditet, semestrin kur ofrohet secilam tipin (e detyruar ose me zgjedhje), si dhe lektorët përkatës.

Lëndët	ECTS	Leksionet	Sesionet e ushtrimeve	Totali	Semestri	Tipi i lëndës/Lektori
Ekonomiksi i avancuar në sektorin publik	6	30	30	60	I	E detyruar/ Ermira Kalaj
Kontabiliteti i sektorit publik	6	30	30	60	I	E detyruar / Albana Kastrati
Politikat fiskale	6	30	30	60	I	E detyruar / Erjola Barbullushi

Menaxhimi financiar i institucioneve publike	6	30	30	60	I	E detyruar / Auora Kinka
Kontrolli dhe auditimi në sektorin publik	6	30	30	60	I	E detyruar / Elez Osmani
Totali Semestri I	30	150	150	300		
Semestri II						
Analiza e buxhetit të shtetit	5	30	20	50	II	E detyruar / Fatbardha Molla
Lëndë me zgjedhje 1*	5	30	20	50	II	Lëndë me zgjedhje
Lëndë me zgjedhje 2 *	5	30	20	50	II	Lëndë me zgjedhje
Praktika profesionale	5			150	II	Lëndë me zgjedhje
Teza e diplomës	10				II	Lëndë me zgjedhje
Totali Semestri II	30	90	60	300		

Lëndët me zgjedhje:

- ❖ Menaxhimi i burimeve nejrëzore në sektorin publik – Mario Çurçija
- ❖ Prokurimet publike – Lektor nga Fakulteti i Drejtësisë
- ❖ Marketingu i shërbimeve dhe mjedisi elektronik – Arjeta Troshani, Brilanda Bushati
- ❖ Menaxhimi dhe modelimi financiar në sektorin publik– Kleida Heta
- ❖ Menaxhimi i riskut në institucionet e sektorit publik – Peter Saraçi
- ❖ Etika ne sektorin publik – Nevila Kiri

3. Feedback-u i studentëve mbi programin (Lëndët e semestrit të parë)

Me qëllim që të sigurohet një feedback mbi përfitimet e studentëve pjesëmarrës nga programi, është zhvilluar me ta një survejim në fund çdo lënde të ofruar në semestrin e parë. E njëjta praktikë do të ndiqet edhe në fund të semestrit të dytë. Pyetësi i shpërndarë për qëllimet e këtij survejimi përmbante 15 pyetje. Ata kishin si qëllim të zbulonin nëse studentët ishin të kënaqur me procesin mësimor, njohuritë e marra gjatë lëndës si dhe komunikimin e marrëdhënien e vendosur me pedagogun. Pyetjet e përfshira në pyetësor janë si më poshtë:

- a) Sa kurse të tjera në fushën e menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit keni ndjekur deri tani?
- b) A mendoni se keni mësuar shumë nga ky kurs?
- c) A jeni ndjerë të motivuar nga ky kurs?
- d) A do ta rekomandonit këtë kurs?
- e) A ishin përgatitur mirë seancat e leksioneve dhe seminareve?
- f) A ishte paraqitur materiali në mënyrë të qartë dhe logjike?
- g) A ishin materialet studimore të ofruara, të rëndësishme për të kuptuar këtë kurs?
- h) A ishin përcaktuar qartë kriteret për vlerësimin tuaj?
- i) A ishte kursi një përvojë e vlefshme?
- j) A ka arritur lektori të krijojë një raport pozitiv me studentët?
- k) A ishte lektori tolerant për të gjithë studentët e grupit?
- l) A do të dëshironit një kurs tjetër me këtë lektor?
- m) Nëse ka patur lektorë të ftuar në kurs, a ishin ato interesante dhe të dobishëm?
- n) Si krahasohet ky kurs me kurse të tjera që keni ndjekur në studimet tuaja të mëparshme universitare?
- o) Si ju duken studimet në Fakultetin Ekonomik në krahasim me fakultetin tuaj të mëparshëm?

Shumica e pyetjeve të sipërpërmendura janë strukturuar sipas formatit të shkallës së Likertit, me 5 nivele, si vijon: Absolutisht Jo (ose jo dakort), Jo (jo dakort), Neutral, Po (dakort), Absolutisht Po (dakort). Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur rezultatet eurvejimit për çdo lëndë dhe lektor.

❖ **Kontabiliteti i Sektorit Publik**, Lektore, **Dr. Albana Kastrati**

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 72% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po, 16% po, 8% neutral dhe 4% jo.
- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 56% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 40% po dhe 4% neutral.
- ✓ Dr. Albana Kastrati është vlerësuar lart edhe për përgatitjen e mirë të leksioneve dhe seksioneve të seminareve. Në fakt, në lidhje me këtë, 88% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po. Ajo është vlerësuar mjaft mirë edhe për prezantimin e qartë dhe logjik të materialeve si dhe për ndërtimin e marrëdhënieve të mira me studentët.

❖ **Menaxhimi Financiar i Institucioneve Publike**, Lektore, **Dr. Aurora Kinka**

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 78% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po, 18% po, dhe 4% neutral.
- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 75% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 21% po dhe 4% neutral.
- ✓ Dr. Aurora Kinka është vlerësuar mjaft lart gjithashtu edhe në lidhje me pyetjet e tjera. Në të gjitha pyetjet e tjera 85% ose me shumë e studentëve janë përgjigjur absolutisht po, duke konfirmuar nivelin e lartë të kenagesisë së marrë prej tyre si nga lënda ashtu edhe nga

pedagogia përkatëse. Në mënyrë të veçantë, të pyetur nëse lektorja kishte qenë njëloj tolerant me të gjithë studentët apo nëse ata do të ndiqnin një tjetër kurs të ofruar nga kjo lektore, 96.4% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po.

❖ **Kontrolli dhe Auditimi në Sektorin Publik**, Lektor, **Prof. Dr. Elez Osmani**

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 44% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po, 36% po, dhe 20% neutral.
- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 48% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 36% po, 12% neutral dhe 4% jo.
- ✓ Prof. Dr. Elez Osmani është vlerësuar gjithashtu lart për prezantimin e mirë të leksioneve dhe seksioneve të seminareve, për prezantimin e qartë dhe logjik të materialeve të lëndës, si dhe për ndërtimin e marrëdhënieve të mira me studentët. Veçanërisht, të pyetur nëse lektori kishte qenë njëloj tolerant me të gjithë studentët, 92% e tyre u përgjigjën absolutisht po.

❖ **Politkat Fiskale**, Lektore, **Dr. Erjola Barbullushi**

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 47% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po, 39% po, dhe 14% neutral.
- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 47% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 39% po dhe 14% neutral.
- ✓ Dr. Erjola Barbullushi është vlerësuar mjaft mirë gjithashtu në lidhje me përgatitjen e leksioneve dhe seksioneve të seminareve, për prezantimin logjik e të qartë të materialeve të kursit, si dhe për ndërtimin e mirë të marrëdhënieve me studentët. Veçanërisht, lidhur me këtë të fundit, 89.3% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po.

❖ **Ekonomiksi i Avancuar në Sektorin Publik**, Lektore, **Prof. As. Dr. Ermira Kalaj**

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 53% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po, 43% po, dhe 4% neutral.
- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 64% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 29% po, dhe 7% neutral.
- ✓ Prof. As. Dr. Ermira Kalaj është vlerësuar lart gjithashtu për përgatitjen e mirë të leksioneve dhe seksioneve të seminareve dhe shpjegimin e qartë dhe logjik të materialeve të kursit. Në veçanti, lidhur me këtë të fundit, 92.6% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po. Studentët vlerësuar shumë edhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira të kësaj pedagogjeje me studentët.

❖ **Analiza e buxhetit të shtetit**, Lektore, **Prof. Dr. Fatbardha Molla**

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 51% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po, 43% po, dhe 6% neutral.
- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 83% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 17% po.

- ✓ Prof. Dr. Fatbardha Molla është vlerësuar lart gjithashtu për përgatitjen e mirë të leksioneve dhe seksioneve të seminareve dhe shpjegimin e qartë dhe logjik të materialeve të kursit. Studentët kane vlerësuar shumë edhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira të kësaj pedagoqeje me studentët e kursit.

❖ **Menaxhimi dhe modelimi financiar në sektorin publik, Lektore, Dr. Kleida Heta**

Lenda është me zgjedhje dhe e kanë zgjedhur ta frekuentojnë 13 studente, nga numri total i kursit

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 92% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po, 8% po.
- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 64% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 92% po, dhe 8% neutral.
- ✓ Dr. Kleida Heta është vlerësuar lart gjithashtu për përgatitjen e mirë të leksioneve dhe seksioneve të seminareve dhe nderveprimin e saj me klasen, duke bere te mundur qe seancat te ishin interaktive. Në veçanti, lidhur me këtë të fundit, 100% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po. Studentët kane vlerësuar shumë te mire edhe ndërtimin e marrëdhënieve të kësaj pedagoqeje me studentët.

❖ **Menaxhimi i burimeve njerëzore në sektorin publik, Lektor, Dr. Mario Çurçija**

Lenda është me zgjedhje dhe e kanë zgjedhur ta frekuentojnë 12 studente, nga numri total i kursit

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 75% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po, 25% po.
- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 50% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 42% po, dhe 8% neutral.
- ✓ Dr. Mario Curcija është vlerësuar lart gjithashtu për përgatitjen e mirë të leksioneve dhe seksioneve të seminareve dhe nderveprimin e tij me klasen. Shquhet per qartesi ne shpjegim. Në veçanti, lidhur me këtë të fundit, 91% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht pod he vetem 9% prej tyre u pergjigjen po. Studentët kane vlerësuar shumë te mire edhe ndërtimin e marrëdhënieve të këtij pedagogu me te gjithë studentët.

❖ **Etika ne sektorin publik, Lektore, Dr. Nevila Kiri**

Lenda është me zgjedhje dhe e kanë zgjedhur ta frekuentojnë 12 studente, nga numri total i kursit

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 58% e studentëve tëurvejuar u përgjigjën absolutisht po, 33% po dhe 9% e tyre jane neutral ne dhenien e pergjigjes.

- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 67% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 33% po.
- ✓ Dr. Nevila Kiri është vlerësuar lart gjithashtu për përgatitjen e mirë të leksioneve dhe seksioneve të seminareve dhe nderveprimin e saj me klasen, duke bere te mundur qe seancat te ishin interaktive. Në veçanti, lidhur me këtë të fundit, 100% e studentëve të survejuar u përgjigjën absolutisht po. Studentët kane vlerësuar shumë te mire edhe ndërtimin e marrëdhënieve të kësaj pedagogeje me studentët.

❖ **Menaxhimi i riskut në institucionet e sektorit publik, Lektor, Dr. Peter Saraci**

Lenda eshte me zgjedhje dhe e kane zgjedhur ta frekuentojne 8 studente, nga numri total I kursit

- ✓ Të pyetur nëse kishin mësuar shumë nga ky kurs, 87% e studentëve të survejuar u përgjigjën absolutisht po, 33% po.
- ✓ Të pyetur nëse ishin ndjerë të motivuar nga kursi, 87% e studentëve u përgjigjën absolutisht po, 33% po.
- ✓ Dr. Peter Saraci është vlerësuar lart gjithashtu për përgatitjen e mirë të leksioneve dhe seksioneve të seminareve dhe nderveprimin e tij me klasen. Shquhet per qartesi ne shpjegim. Në veçanti, lidhur me këtë të fundit, 91% e studentëve të survejuar u përgjigjën absolutisht pod he vetem 9% prej tyre u pergjigjen po. Studentët kane vlerësuar shumë te mire edhe ndërtimin e marrëdhënieve të këtij pedagogu me te gjithe studentët.

Me 13 Qershor 2019, studentet e master – it FINAC kane bere prezantimin e praktikes para komisioneve perkatese. Periudha e praktikës i ndihmon ta zhvillojnë njohuritë praktike për të gjitha kurset që kanë zhvilluar gjatë kësaj periudhe. Praktika finalizohet me një prezantim para komisioneve përkatëse dhe evidencën e një dokumenti që firmoset dhe vulozet nga institucioni ku studentët kanë përmbushur periudhën e praktikës.

Tani studentet e këtij master – i po pergatisin tezën e diplomës. Data e mbrojtjes së diplomave do të jetë data 26 Korrik 2019. Në këtë sezon diplomohen 20 studentë të regjistruar ose 50% e numrit total të tyre. Sezoni tjetër i mbrojtjes së diplomave në këtë vit akademik është 23 – 27 shtator.

Lista e studenteve qe kanë dorëzuar temat për mbrojtje në Korrik 2019 është si më poshtë:

	Emri i studentit		Titulli i tezës së diplomës	Emri i udhëheqësit
1	Gusha	Emond	Roli i auditit tek prokurimet publike (Rast studimor Spitali rajonal Shkoder)	Nevila Kiri
2	Curcija	Erard	Investimet e huaja direkte ne Shqiperi	Erjola Barbullushi

3	Qallija	Saida	informaliteti nga kendveshtrimi konsumator	Erjola Barbullushi
4	Dibra	Rovena	Zhvillimi i internetit banking ne Shqiperi	Elez Osmani
5	Kalo	Akil	Buxhetimi dhe policimi ne komunitet ne qarkun Shkoder	Irsida Kopliku
6	Dama	Griselda	Auditimi i brendshem dhe kontrolli, ndikimi i tyre ne sigurine e bankave te nivelit te dyte, rasti i bankes Intesa Sanpaolo	Nevila Kiri
7	Haxhija	Samet	Reforma administrative territoriale dhe ndikimi ne te ardhurat e Bashkise. Rasti I Bashkise Shkoder	Aurora Kinka
8	Deda	Doriana	Shperndarja e fondeve ne arsim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	Fatbardha Molla
9	Plori	Bledar	Administrimi i sherbimeve civil dhe nepunesi civil	Ermira Kalaj
10	Bizaku	Melba	Roli i qeverise ne ekonomi	Elidiana Bashi
11	Djepaxhija	Erjola	Menaxhimi i projekteve ne institucionet publike, rast studimor projekti Helix ne universitetin e Shkodres "Luigj Gurakuqi"	Kleida Heta
12	Dibra	Pranvera	Norma tatimore optimale, Kurba Laffer, rasti I Shqiperise	Ermira Kalaj
13	Kastrati	Agron	Arsimi parauniversitar ne Shqiperi. Rasti ZVAP Shkoder	Albana Borici
14	Hoxha	Valbona	Transparenca ne pushtetin gjyqesor dhe sfidat e reformes ne drejtesi	Blerta Dragusha
15	Kollacej	Ilavio	Marketingu territorial ne Bashkine Shkoder	Arjeta Troshani
16	Ballgjati	Aferdita	Menaxhimi i bibliotekave dhe teknikat buxhetore	Arjeta Troshani

17	Shimaj	Agim	E-qeverisja , e - inspektimi dhe matrica ne inspektoriatin e punes	Brilanda Bushati
18	Gokaj	Inis	Roli i bibliotekes universitare dhe rendesia e digjitalizimit te saj. Rasti i Bibliotekes se Universitetit "Luigj Gurakuqi" dhe arkivat digjitale	Brilanda Bushati
19	Voci	Jasemina	Veshtiresite e biznesit te vogel lidhur me perfshirjen ne skemen e tvsh- se	Albana Borici
20	Kraja	Sanida	Ndarja territoriale e Bashkise Shkoder. Realizimi I te ardhurat sipas njesive Administratice viti 2018	Albana Kastrati

4. Aktivitetet që synojnë qëndrueshmërinë e programit dhe tërheqjen e studentëve për vitin e ardhshëm akademik

Sfida e ardhshme e Fakultetit Ekonomik dhe e Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës lidhur me programin Master Profesional në "Menaxhim Financiar, Kontabilitet dhe Kontroll në Administratën Publike", është akreditimi i këtij program studimi nga Agjensia Shqiptare për Sigurimin e Cilësisë. Departamenti i Financë-Kontabilitetit, i cili e ofron këtë program, në mbledhjen e tij të datës, 28 janar 2019, miratoi përfshirjen e këtij programi në procesin e akreditimit dhe dërgoi pranë Rektoratit të USH-së kërkesën përkatëse. Rektorati nga ana tjetër është në proces për transmetimin e kësaj kërkesë në Agjensinë Shqiptare për Sigurimin e Cilësisë, së bashku me kërkesën për akreditimin e programeve të tjera të studimit të ofruara nga ky universitet. Kapërcimi me sukses i kësaj sfide përbën garanci për qëndrueshmërinë e këtij program dhe tërheqjen e studentëve në vitet e ardhshme akademike. Për vitin e ardhshëm akademik, numri i kuotave të aprovuara nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit është 60, 20 kuota më tepër sesa ato të miratuara për këtë vit akademik.

Për më tepër, me qëllimin që të tërhiqen studentë për vitin e ardhshëm akademik, është planifikuar të organizohet një ceremoni përmbyllëse në fund të programit për këtë vit. Ceremonia do të promovohet në mediat lokale dhe kombëtare, në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës, si edhe në faqet përkatëse në Facebook dhe Instagram të Fakultetit Ekonomik. Përfaqësues nga institucionet publike lokale dhe rajonale do të jenë të ftuar gjithashtu në këtë ceremony.

Fakulteti po punon gjithashtu për përgatitjen e fletëpalosjeve për këtë program që do të shpërndahen tek të gjithë institucionet publike Veriut të Shqipërisë. Njoftimi për hapjen e procedurës së aplikimit për këtë program do të promovohet gjithashtu përmes medias, sitit zyrtar

të USH-së dhe rrjeteve sociale të përmendura më lart. Në vijim janë disa foto nga ceremonia e hapjes së këtij Masteri Profesional më 24 Nëntor 2018.



